



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

BE LAJME

nëntor 2018
EUC-numër 39/2018



MIRATOHET REZOLUTA E PARLAMENTIT EVROPIAN PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË



Përmbajtja e lajmeve:

Miratohet rezoluta e PE-së për RM	1
Në fokusin e Parlamentit Evropian	2-3
Aktivitetet e Kuvendit lidhur me çështjet evropiane	4-5
Letonia iu bashkëngjiti e-bashkëpunimit shëndetësor për mbrojtjen e personalizuar shëndetësore	6
Mekanizmi për bashkëpunim dhe verifikim - progresi i Bullgarisë dhe Rumanisë	6
Përmirësimi i sigurisë së dokumenteve të identifikimit personal	7
Dita evropiane e përdorimit të arsyes në antibiotikë - 2018	7
Rregullativa e re për Agjencinë për Bashkëpunim Gjyqësor të BE - Euro-	8
Java evropiane e shkathtësisë dhe sigurimi i cilësisë në arsimin dhe trajnimin profesional 2018	8
Zgjidhet kandidati i Partisë Popullore Evropiane për zgjedhjet e ardhshme evropiane	9
Planeti i pastër për të gjithë - strategjia e re afatgjatë e BE-së	9
Sistemi për kontrollin e investimeve të huaja në BE	10
Bashkëpunimi në sferën e mbrojtjes - 17 projekte të reja të PESCO	11
Kalendari i BE-së / dhjetor 2018	11

Parlamenti Evropian në sesionin plenar më 29 nëntor 2018 me 470 vota „për“, 116 vota „kundër“ dhe 46 vota „të përmbajtura“ e miratoi [Rezolutën](#) për Raportin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2018 në të cilën kërkohet fillimi i negociatave për anëtarësim në BE në qershor vitin e ardhshëm.

Republika e Maqedonisë duhet të tregojë rezultate në procesin reformues, të nevojshme në sferën e gjyqësisë, luftën kundër korrupsionit dhe ligjet tjera kryesore. Eurodeputetët i ftojnë pushtetet nacionale ta intensifikojnë luftën kundër larjes së parave dhe konfliktit të interesave, me qëllim të mbrojtjes më të mirë të gjyqësisë nga përzierja politike dhe ballafaqimi me probleme të caktuara në sundimin e së drejtës, që vazhdojnë të paraqesin sfida serioze.

Në debat referuesi i PE-së për RM-në, eurodeputeti Ivo Vajgëll theksoi: „Pasi të gjitha kushtet do të përmbushen, anëtarësimi i RM-së në BE do të sigurojë ardhmëri të premtuar për këtë gjeneratë dhe gjeneratat e ardhshme“.

Eurodeputetët e përshëndetën vendimin e Kuvendit për fillimin e procesit kushtetues për zbatimin e Marrëveshjes së Prespës nga 17 qershori i këtij viti ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë. Marrëveshja e hap derën për negociatat aderuese në BE dhe NATO dhe jep sinjal pozitiv për stabilitetin dhe pajtimin në gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, theksuan eurodeputetët në debat.

Referuesi Ivo Vajgëll, por edhe eurodeputetët përkujtuan se jo vetëm Maqedonia, por edhe BE-ja duhet t'i përmbush premtimet e veta në procesin eurointegruar.

Në debat eurokomisionari Han theksoi se vendi kthehet në rrugën euroatlantike dhe i përshëndeti ndryshimet kushtetuese duke i quajtur hap i guximshëm që pret të vazhdojë pa anulim. Me rëndësi të madhe është momenti reformues të thellohet në interes të qytetarëve, deklaroi Han duke

përkujtuar në tri kushtet e përfshira në konkluzionet e Këshillit të BE-së nga qershori – gjyqësia e pavarur dhe lufta kundër korrupsionit, kontrolli i shërbimeve të zbulimit dhe të sigurisë dhe reforma në administratën publike.

Përfaqësuesja e Kryesisë së Austrisë, Karolin Edstadler, ngjashëm si edhe komisionari Han përkujtoi në reformat e mbetura që janë të nevojshme për fillim të negociatave dhe ftoi të gjendet mënyra të sigurohet puna e pandërprerë e Prokurorisë Speciale Publike.

Eurodeputetët i ftuan pushtetet hungareze ta ekstradojnë ish kryeministrin e Maqedonisë, Nikolla Gruevski, në vendin e vet, i cili pasi ishte gjykuar për dënim me burg për korrupsion, iku në Hungari.

Amendamentet e parashtruara nga eurodeputetët grekë në të cilat kërkohet të shlyhet mbiemri „maqedonas“ gjithkund në raport u refuzuan nga shumica e eurodeputetëve.

PE-ja e miratoi Rezolutën për çdo vend kandidat për zgjerim, pas publikimit të raporteve të KE-së për këto vende. Këto rezoluta paraqesin qëndrim zyrtar të Parlamentit Evropian, të cilin Këshilli dhe Komisioni e marrin parasysh edhe pse nuk është i obligueshëm juridikisht.

<http://www.europarl.europa.eu>

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN



Sesioni plenar 12-15 nëntor 2018

Në hapjen e sesionit plenar të PE-së, kryetari Tajani shprehi ngushëllime për familjet e viktimave në kushtet kohore ekstreme në Itali. Ai e falënderoi KE-në për ndihmën për vendet anëtare të BE-së në rastet urgjente, përmes shërbimeve për mbrojtjen civile.

www.europarl.europa.eu

Parlamenti të martën e vërtetoi marrëveshjen e përkohshme të arritur me Këshillin për Efikasitetin Energjetik në qershor (me 434 vota, 104 kundër dhe 37 të përmbajtura), burimet e rinovueshme të energjisë (me 495 vota, 68 kundër dhe 61 të përmbajtja) dhe menaxhimi me Unionin Energjetik (me 475 vota, 100 kundër dhe 33 të përmbajtura) - tri dosje të rëndësishme ligjore që janë pjesë e pakos për energji të pastër për të gjithë evropianët. Deri në vitin 2030, efikasiteti energjetik në BE duhet të përmirësohet për 32,5%, ndërsa pjesëmarrja e energjisë nga burimet e rinovueshme duhet të jetë së paku 32% të konsumimit bruto final të BE-së. Të dyja qëllimet duhet të shqyrtohen deri në vitin 2023. Këto qëllime mund të rriten, e jo të zvogëlohen.

Pasi Këshilli zyrtarisht do ta miratojë marrëveshjen, rregullat e reja do të botohen në Gazetën Zyrtare dhe hyjnë në fuqi 20 ditë pas botimit. Rregullativa për menaxhim do të zbatohet drejtpërdrejtë në të gjitha vendet anëtare, ndërsa vendet anëtare do të duhet t'i transponojnë elementet e reja nga dy direktivat e tjera në legjislacionin nacional më së voni 18 muaj pas hyrjes së saj në fuqi.

Në sesion eurodeputetët lejuan 17.730.519 euro ndihmë për kompensimit e dëmit të shkaktuar nga vërshimet intensive në Letoni në verën dhe vjeshtën e vitit 2017. Ndihma vjen nga Fondi i Solidaritetit të BE-së (EUSF). Raporti i Ines Vajdere (EPP) i cili rekomandon miratim të shpejtë të vendimeve ishte miratuar me 402 vota, 25 kundër dhe 7 të përmbajtura.

Fondi i Solidaritetit i BE-së ishte formuar që t'u përgjigjet katastrofave të mëdha natyrore dhe ta shpreh solidaritetin evropian për rajonet e prekura me katastrofat në Evropë.

Në drejtim të diskriminimit të përhershëm, PE-ja fton në rregulla të përbashkëta me të cilat do të sigurohet respektimi i të

drejtave i të gjitha pakicave nacionale nëpër BE. Eurodeputetët e ftojnë KE-në të hartojë direktivë për standardet minimale për pakicat në BE, duke përfshirë përcaktues dhe masa për parandalimin e diskriminimit të pakicave nga vendet anëtare. Në rezolutën e miratuar eurodeputetët, po ashtu, ftojnë në përkufizimin e përbashkët për pakicat dhe rekomandojnë miratimin e përkufizimit të përcaktuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR).

PE-ja është „e shqetësuar thellë“ lidhur me reformën në ligjet penale dhe gjyqësore rumune, që rrezikon minimin e ndarjes së pushtetit dhe luftës kundër korrupsionit. Ndryshimet në Kodin Penal dhe Ligjin për procedurë penale - nga të cilat shumicën, Gjykata Kushtetuese e Rumanisë i konsideron jokushtetuese - paraqesin edhe një burim të shqetësimit, me efekte shtesë mbi kapacitetin për luftën kundër korrupsionit, veprave të dhunshme penale dhe krimit të organizuar.

Miratimi i propozim-rregullave të reja nga eurodeputetët sugjerojnë se si, ku dhe kur peshqit e vegjël pelagjikë, siç janë ari dhe sardelja, mund të kapen në Detin Adriatik. Plani i propozuar shumëvjeçar, i miratuar me 342 vota për, 295 vota kundër dhe 24 vota të përmbajtura, do të vendos mundësi për peshkim të llojeve të vogla që jetojnë në afërsinë e sipërfaqes së Detit Adriatik, kryesisht ari dhe sardelja.

Komisioni duhet ta vlerësojë ndikimin e planit shumëvjeçar tre vjet pas hyrjes së tij në fuqi dhe të propozojë, nëse nevojitet, ndryshime të rregullativës.

NË FOKUSIN E PARLAMENTIT EVROPIAN

„Toleranca është shpirti i Evropës dhe është vlera themelore esenciale e idesë evropiane“, theksoi kancelaria gjermane Angela Merkel në debatin për ardhmërinë e Evropës me eurodeputetët dhe kryetarin e KE-së, Zhan Klod Junker. Megjithatë, në vitin e fundit, ky shpirt është i tensionuar nga shumë sfida të ndryshme siç janë: borxhi publik, terrorizmi, luftërat të cilat u zhvilluan afër kontinentit tonë, migrimi, digjitalizimi ose ndryshimet klimatike.

Edhe krahas rregullave të kontraktuara të zakonshme, duke i vendosur kriteret për atë se kush mund të marrë leje për eksport të armëve, vendet anëtare në mënyrë sistematike nuk kanë arritur t'i zbatojnë. PE-ja kërkon mekanizëm për zbatimin e sanksioneve për vendet anëtare të BE-së të cilat i shkelin rregullat. Rregullat e përbashkëta për eksportin e armëve janë me rëndësi esenciale që t'u shmangen keqpërdorimeve të të drejtave të njeriut dhe të parandalohet përdorimi i armëve evropiane kundër forcave të armatosura evropiane, theksuan eurodeputetët.

Eurodeputetët në sesionin plenar e vërtetuan pozitën e tyre për buxhetin e ardhshëm afatgjatë të BE-së, duke e përfshirë edhe analizën e saktë të shumave për çdo program të BE-së.

PE-ja e vërtetoi marrëveshjen e përkohshme të arritur me Këshillin e Ministrave në qershor për Kodin Evropian për Komunikime Elektronike (EECC) me 584 vota për, 42 kundër dhe 50 të përmbajtura, ndërsa Trupi i Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike (BEREC) me 590 vota për, 63 kundër dhe 23 të përmbajtura. Rregullat e reja do t'u mundësojnë qytetarëve shpejtësi më të madhe për lidhjen dhe thirrje të sigurta të arritshme në kornizat e BE-së, njëkohësisht duke siguruar parashikim të domosdoshëm për operatorët telekomunikues t'i rrisin investimet në internetin e shpejtë.

Për zvogëlimin e emisioneve të gazrave serrë të BE-së deri në vitin 2030 eurodeputetët miratuan pjesë të madhe (35%) të KE-së (30%) për kamionë të rinj, me qëllim të mesëm prej 20% deri në vitin 2025. Prodhuesit, gjithashtu, duhet të sigurojnë se mjetet me zero emision dhe emision të ulët (të cilat lëshojnë së paku 50% më pak emisione) paraqesin 20% të pjesës së tregut në shitjen e mjeteve të reja deri në vitin 2030 dhe 5% deri në vitin 2025.

BE-ja duhet të hartojë plan për luftën kundër sëmundjes „epidemia e qetë“ të përhapur me rriqra, e cila mbetet e pashënuar dhe ndikon në afër një milionë evropianë. Deputetët u shprehën të shqetësuar për shkallën alarmante me të cilën kjo sëmundje përhapet nëpër BE, në rezolutën e miratuar me ngritjen e duarve.

Të drejtat e ripërtërira të udhëtarëve në komunikacionin hekurudhor duhet të përfshijnë shkallë të larta të kompensimit për anulimet dhe ndihmën e mirë për personat me lëvizje të zvogëluar. Eurodeputetët i mbështetën ndryshimet e rregullave nga viti 2009 që kanë për qëllim të sigurojnë ndihmë më të mirë për personat me lëvizje të zvogëluar, qasje më të mirë për biciklistët dhe veprimet e qarta për përgatitjen e ankesave. Krahas kësaj, kompanitë hekurudhore duhet t'i përmirësojnë informatat që u janë dhënë udhëtarëve për të drejtat e tyre dhe ta rrisin kompensimin që u paguhet në rast të anulimeve.

Sesioni plenar 28-29 nëntor 2018

Në sesionin plenar, eurodeputetët thanë se kontrollet e brendshme kufitare në kornizat e Zonës së Shengenit duhet të kufizohen në maksimum një vjet.

Eurodeputetët në tri rezolutat e miratuara e vlerësuan progresin e arritur në vitin 2018 në RM, Shqipëri dhe Mal të Zi në rrugën e tyre drejt aderimit të mundshëm në BE.

Gjithashtu, PE-ja kërkoi hetim, ndryshime vendimtare dhe pushtete të fuqishme tatimore si rezultat i mashtrimit tatimor prej 55 miliardë euro, me të cilën u përfshinë 11 vende anëtare të BE-së.



www.europarl.europa.eu

AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE



www.sobranie.mk

Më 05 nëntor 2018, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, realizoi takim me Wolfgang Sobotka, kryetar i Këshillit Nacional të Republikës së Austrisë, i cili qëndroi në vizitë zyrtare njëditore në Republikën e Maqedonisë.

Në takim, të dy burrshtetasit e lartë u angazhuan për mbajtjen dhe mbindërtimin e mëtejshëm dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve ekzistuese, si në nivel parlamentar, ashtu edhe në nivel shtetëror. Kryetari Xhaferi falënderoi për mbështetjen e parzërvë që Republika e Austrisë e jep për Republikën e Maqedonisë në përpjekjet e saj për integrimin në strukturat euroatlantike, mbështetjen që është dhënë edhe me Strategjinë e Komisionit Evropian për Ballkanin, megjithatë edhe me rolin aktual të kryesuesit me BE-në. Kryetari i Këshillit Nacional të Republikës së Austrisë, Wolfgang Sobotka, iu drejtua deputetëve në Seancën nr. 63 të Kuvendit që u mbajt më 05.11.2018.



DELEGACIONI I KUVENDIT NË SESIONIN E 64-T VJETOR TË AP-SË SË NATO-S NË HALIFAKS, KANADA

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, dhe Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në AP-në e NATO-s në përbërje: Ilija Dimovski, Katerina Kuzmanovska dhe Vesel Memedi, morën pjesë në Sesionin e 64 -t Vjetor të Asamblesë Parlamentare të NATO-s, që u mbajt më 16-19 nëntor 2018 në Halifaks, Kanada. Me ftesë të AP-së së NATO-s, në sesionin plenar mbajti fjalim Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi. Në fjalimin e vet, z. Xhaferi, e përshëndeti mbështetjen e kryetares së Asamblesë Parlamentare të NATO -s, znj. Raza Jukneviene për Republikën e Maqedonisë në rrugën e saj drejt Aleancës së NATO-s, si dhe angazhimit të NATO-s përmes dërgimit të ftesës për anëtarësim të Republikës së Maqedonisë në NATO para disa muajsh. „Për gjithë këtë periudhë, sado qoftë kontributi ynë i vogël ose i madh pjesëtarët e forcave tona të sigurisë, të cilët janë pjesë e operacioneve paqësore të NATO-s janë profesionistë të vërtetë me vlera, shkathtësitë dhe standarde të larta, të barabarta për të gjithë pjesëtarët e strukturave të NATO-s. Ky është vërtetim se po mësojmë, po rritemi dhe po zhvillohemi, si forca të sigurisë, megjithatë në të njëjtën kohë, edhe si shoqëri, edhe si shtet“ - theksoi z. Xhaferi.



Në sesionin vjetor të AP-së së NATO-s, delegacioni ynë mori pjesë edhe në punën e komiteteve, ku mes tjerash, u diskutua për sigurinë në Ballkanin Perëndimor, me ç'rast u përmend se Republika e Maqedonisë mori ftesë formale për Samitin e NATO -s, por vendi do të bëhet anëtare e plotfuqishme vetëm pas zgjidhjes së plotë të kontestit me emrin.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ka status të anëtarit asociativ në AP-në e NATO-s nga viti 1994 dhe kjo është për herë të parë që Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të ftohet të mbajë fjalim para parlamentarëve në këtë organizatë të respektuar ndërkombëtare që bashkon mbi 260 parlamentarë të vendeve anëtare të NATO-s, vendeve asociative, vendeve mbikëqyrëse, parlamenteve partnere dhe përfaqësuesve nga organizatat e tjera ndërkombëtare.

AKTIVITETET E KUVENDIT LIDHUR ME ÇËSHTJET EVROPIANE

Kryetari i Kuvendit, Talat Xhaferi më 14 nëntor 2018, u takua me Kryeministrin e Maltës Josef Muskat i cili ishte në vizitën e tij të parë zyrtare në Maqedoni. Takimi kaloi në atmosferë miqësore dhe konstruktive dhe u shkëmbyen informata dhe mendime mbi bashkëpunimin e ardhshëm midis dy vendeve, si politikisht dhe ekonomikisht. Kryetari i Kuvendit shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e deritanishme të Maltës për proceset tona të integritetit evropian dhe theksoi se ndihma dhe përvoja që mund të marrim nga Republika e Maltës janë të mirëseardhura. Kryeministri i Maltës shprehu kënaqësinë për pritjen e ngrohtë dhe miqësore në vend dhe shpreson se marrëdhëniet e mira do të vazhdojnë të zhvillohen në të ardhmen. Gjithashtu, kryeministri i Maltës ka shprehur gatishmërinë e vendit të tij për të mbështetur Republikën e Maqedonisë në fushën e integritetit në BE dhe me programe dhe plane të veçanta.



www.sobranie.mk



Në kuadër të vizitës dy ditore në Bruksel më 27 dhe 28 nëntor 2018, delegacioni i Kuvendit në përbërje: Goran Milev, Ejup Alimi, Meri Llazarova dhe Nikolla Micevski morën pjesë në tryezën e dytë të rrumbullakët në nivel të lartë, me ftesë të kryetarit të Parlamentit Evropian Antonio Tajani. Në diskutim ishin dy pika në agjendë: Reformat e BE dhe përmirësimi i marrëdhënieve dypalëshe në vendet e Ballkanit Perëndimor, deputetët Goran Milevski dhe Meri Lazarova kishin fjalime. Ata informuan për rezultatet e arritura në reformat e BE-së dhe zbatimin e Marrëveshjes së Prespës. U theksua nevoja që vendi të marrë një datë për fillimin e negociatave në qershor të vitit të ardhshëm në mbledhjen e Këshillit Evropian. Delegacioni i Kuvendit u takua me Raportuesin e Komisionit për Politikë të Jashtme në Parlamentin Evropian për Republikën e Maqedonisë, Ivo Vajgl, si dhe me eurodeputetët Knut Flechenstein, Eduard Kukan, Alois Peterle dhe Reinhart Boutihofer. Në takimet e mbajtura pak përpara debatit mbi Rezolutën për përparimin e Republikës së Maqedonisë në vitin 2018, delegacioni ynë konfirmoi vendosmërinë e vendit për integrimin euroatlantik dhe gatishmërinë për të zbatuar reformat e BE - së, të cilat BE i kërkon nga ne. Delegacioni gjithashtu mori pjesë në seancën plenare të Parlamentit Evropian, gjatë së cilës u diskutua Rezoluta.

Delegacioni i Komisionit të Çështjeve Evropiane i Kuvendit, i përbërë nga Shpresa Hadri, Lidija Tasevska dhe Vlladanka Aviroviq, morën pjesë në Konferencën dy-ditore të Komisioneve për Çështje Evropiane, të mbajtur më 18-20 nëntor në Vjenë. Zgjerimi i mëturshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të debatit për realizimin e prioriteteve të Presidencës austriake të Këshillit të BE-së, me fjalimet hyrëse të Kryetarit të Këshillit Kombëtar Austriak, Sobotka dhe Kryetarit të Këshillit Federal Austriak, Posh-Gruzka, Shefi i Delegacionit Shpresa Hadri kishte fjalim me ç'rast falënderoi mbështetjen austriake për zgjerimin e mëtejshëm të BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor.



Me ftesë të Parlamentit Evropian, kryetari i Komisionit Parlamentar për Kulturë Irena Stefoska mori pjesë në takimin e komisioneve ndërparlamentare me temë "Trashëgimia Kulturore Evropiane" e mbajtur në Parlamentin Evropian në Bruksel më 20 nëntor. Deputetja Stefoska kishte fjalim me temë "Trashëgimia kulturore në Republikën e Maqedonisë: bazë për të ardhmen". Ajo theksoi se trashëgimia kulturore është segment kryesor në përkufizimin e kulturës dhe zhvillimin e civilizimit në shoqërinë maqedonase.

LETONIA IU BASHKËNGJIT BASHKËPUNIMIT SHËNDETËSOR ELEKTRONIK PËR MBROJTJE SHËNDETËSORE TË PERSONALIZUAR



Letonia nënshkroi Deklaratën Evropiane për bashkimin e bazave të gjenomëve të të dhënave përtej kufijve, që ka për qëllim të përmirësojë kuptimin dhe parandalimin e sëmundjeve dhe të mundësojë trajtim më të personalizuar, në veçanti për sëmundjet e rralla, kancerin dhe sëmundjet e trurit.

Deklarata është një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet vendeve që kërkojnë të sigurojnë qasje të sigurt dhe të autorizuar ndërkufitare për bankat kombëtare dhe rajonale të të dhënave gjenetike dhe shëndetësore në përputhje me të gjitha rregullat e BE-së për mbrojtjen e të dhënave. Qëllimi është gjithashtu të mbajë BE-në në një avantazh global në aspektin e mjekësisë të personalizuar, duke

inkurajuar në të njëjtën kohë rezultatet shkencore dhe konkurrencën industriale.

Letonia është nënshkruesi i 19-të i Deklaratës, botuar fillimisht më 10.04.2018 dhe tashmë është nënshkruar nga Austria, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Qipro, Estonia, Finlanda, Greqia, Italia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Britania e Madhe. Në prill të këtij viti, Komisioni Evropian propozoi një Plan Veprimi për të siguruar të dhëna për kujdesin shëndetësor, duke inkurajuar bashkëpunimin Evropian

<https://ec.europa.eu>

MEKANIZËM PËR BASHKËPUNIM DHE VERIFIKIM - PROGRESI BULLGARI DHE RUMANI



Komisioni Evropian, në kuadër të Mekanizmit të Bashkëpunimit dhe Verifikimit, publikoi raportet e fundit mbi hapat e ndërmarrë nga Bullgaria dhe Rumania për të përmbushur detyrimet e tyre në reformën gjyqësore dhe në luftën kundër korrupsionit. Bullgaria në mënyrë plotësuese dhe detyrimet në pjesën e kimit të organizuar.

Raporti i Bullgarisë vë në dukje përparimin e bërë në vitin e kaluar në përmbushjen e 17 rekomandimeve të paraqitura në Raportin e Komisionit të janarit 2017 dhe përpjekjet pozitive të vazhdueshme dhe përcaktimin e shtetit për zbatimin e rekomandimeve.

Komisioni Evropian është i bindur se Bullgaria, në përputhje me tendencën aktuale pozitive, do të jetë në gjendje të përmbushë të gjitha rekomandimet e tjera, dhe kështu standardet të tjera. Kjo do të lejojë që Mekanizmi i Bashkëpunimit dhe Verifikimit të Bullgarisë të përfundojë para përfundimit të mandatit aktual të Komisionit, i cili është në përputhje me udhëzimet e Presidentit të KE-së Zhan Klod Junker që nga fillimi i mandatit të tij.

Raporti mbi Rumaninë thekson se ndërsa vendi ka ndërmarrë disa hapa për të zbatuar 12 rekomandimet e fundit të Raportit të Komisionit të janarit 2017, zhvillimet e fundit kanë penguar rrjedhën e progresit dhe ka vënë në pikëpyetje vlerësimin pozitiv.

Rekomandimet nuk janë më të mjaftueshme për të përmbushur udhëzimet e Presidentit Zhan Klod Junker për të përfunduar Mekanizmin e Bashkëpunimit dhe Verifikimit, para skadimit të mandatit të këtij komisioni. Prandaj, në Raport janë paraqitur një numër rekomandimesh shtesë, të cilat duhet të adresohen urgjentisht. Zbatimi urgjent i masave shtesë është thelbësor që procesi i reformës përsëri të rikthehet në rrugën e duhur dhe të vazhdojë të zbatojë konkluzionet e Mekanizmit të Bashkëpunimit dhe Verifikimit të përcaktuara në Raportin e Janarit 2017

<http://europa.eu>

PËRMIRËSIMI I SIGURISË SË DOKUMENTEVE PËR IDENTIKIFIM PERSONAL

Me qëllim të reduktimit të mashtrimit me identitetin e dokumenteve personale, më 14.11.2018, ambasadorët e Bashkimit Evropian konfirmuan qëndrimin e Këshillit, për një draft rregullore që do të forconte sigurinë e kartave të identitetit, dokumentet e qëndrimit të lëshuara për qytetarët e Bashkimit Evropian.

Vitet e fundit u vendosën standarde të përbashkëta të sigurisë të Bashkimit Evropian për identitet dhe dokumente udhëtimi, përfshirë pasaporta dhe leje qëndrimi për shtetasit e vendeve të treta. Megjithatë, sipas rregullave ekzistuese, nivelet e sigurisë të letërnjoftimeve nacionale dhe dokumentet për qytetarë rezident të BE-së, dallohen dukshëm me çka rritet rreziku nga mashtrimi me dokumentet. Rregullat e reja janë të përcaktuara në projekt-rregulloren e propozuar nga Komisioni Evropian më 17 prill 2018.

Rregullat e reja duhet të përmirësojnë sigurinë e dokumenteve me vendosjen e standardeve minimale si për informacionin që përmbajnë ato dhe për tiparet e sigurisë të përbashkëta për të

gjitha shtetet anëtare të BE-së të cilat i lëshojnë.

Sipas rregullave të reja të propozuara, kartat e identitetit duhet të prodhohen në një format të kartës së kreditit të unifikuar (ID-1), të përfshijë një zonë të lexueshme me makinë dhe të ndjekë standardet minimale të sigurisë të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO). Ato, gjithashtu do të duhet të përmbajnë fotografi dhe dy shenjat e gishtërinjve, të mbajtësit të kartës në format digjital në çip pa kontakt.

Kartat e identitetit do të kenë një periudhë maksimale vlefshmërie deri në 10 vjet. Shtetet anëtare të BE-së mund të lëshojnë letërnjoftime me kohëzgjatje më të gjatë për personat e moshës 70 vjeç ose më tepër. Letërnjoftimet për fëmijë të moshës nën 12 vjeç do të kenë periudhë maksimale të kohëzgjatjes prej 5 vjet.

<https://www.consilium.europa.eu>



DITA EVROPIANE E PËRDORIMIT RACIONAL TË ANTIBIOTIKËVE - 2018

Dita Evropiane për Përdorimin Racional të Antibiotikëve festohet çdo vit më 18 nëntor për të rritur ndërgjegjësimin për kërcënimin e shëndetit publik nga rezistenca antibiotike dhe rëndësia e përdorimit të tyre në mënyrë të arsyeshme.

Të dhënat e fundit konfirmojnë se numri i pacientëve të infektuar nga bakteret rezistente në Bashkimin Evropian po rritet, me rezistencën ndaj antibiotikëve që përbëjnë një kërcënim të madh për shëndetin publik.

Përdorimi i arsyeshëm i antibiotikëve mund të ndihmojë në parandalimin e baktereve rezistente në zhvillimin e tyre dhe kështu antibiotikët do të arrijnë efektet e dëshiruara për gjeneratat e ardhshme. Lufta kundër rezistencës antimikrobike është një prioritet për EFSA - Autoriteti Evropian i Sigurisë Ushqimore. Shkencëtarët e EFSA

punojnë me Qendrën Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve (ECDC) në raportin e fundit vjetor për nivelet e rezistencës ndaj baktereve që gjenden në njerëz, ushqim dhe kafshë.

Me rastin e Ditës Evropiane për Përdorimin Racional të Antibiotikëve, mjekët, infermierët, menaxherët e spitaleve, farmakologët, fermerët, veterinerët, politikanët, organizata profesionale dhe të pacientëve, institucionet qeveritare dhe publiku i gjerë dërgojnë mesazhe përmes Twitter, Facebook ose Instagram duke informuar për gjithçka që ndërmerret për t'u siguruar që antibiotikët të mbeten efektivë.

#KeepAntibioticsWorking

<https://antibiotic.ecdc.europa.eu>



RREGULLATIVË E RE PËR AGJENCINË PËR BASHKËPUNIM GJYQËSOR TË BASHKIMIT EVROPIAN



Më 6 nëntor 2018, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi Rregulloren e Eurojust, pasi Parlamenti Evropian e miratoi atë paraprakisht në tetor. Ky hap plotëson punën legjislative të Bashkimit Evropian, për të krijuar arkitekturë të re të sigurisë për BE-në për përforsimin e luftës kundër krimit ndërkufitar, shërbim më të mirë dhe mbrojtje të qytetarëve të BE-së.

Eurojust do të zëvendësojë vendimin ekzistues të Këshillit dhe do të zbatohet deri në fund të vitit 2019. Pas reformës së Europolit dhe Frontex, si dhe krijimi i Zyrës së Prokurorit Publik Evropian, Eurojust përfundon drejtësinë penale të BE nëpërmjet krijimit të Eurojust si Agjenci e BE-së për Bashkëpunimin në të drejtën penale.

Eurojust rishikon strukturën e menaxhimit me krijimin e Bordit Ekzekutiv për trajtimin e çështjeve administrative. Kolegjiumi i Eurojust, i përbërë nga prokurorë nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, do të jetë në gjendje të përqendrohet më shumë në çështjet operacionale. Rritja e numrit të rasteve të Eurojust-it, takimeve koordinuese, qendrave koordinuese dhe ekipet e përbashkëta hetimore kërkojnë një mënyrë më efikase të trajtimit të rasteve.

Eurojust nuk zëvendëson konceptin e suksesshëm thelbësor të mbështetjes së autoriteteve kombëtare në hetimet dhe ndjekjet e tyre dhe zbulimin e lidhjeve midis rasteve. Ai konfirmon rolin e tanishëm proaktiv të Eurojustit në punën e tij operacionale, strategjike dhe taktike.

Eurojust është në përputhje me rregullat e mbrojtjes së të dhënave të miratuara kohët e fundit nga Bashkimi Evropian, duke marrë parasysh mandatin specifik të Eurojust për përpunimin e të dhënave në interes të luftës kundër krimit ndërkufitar.

Eurojust përfshin rregulla për bashkëpunim me Prokurorinë Publike Evropiane.

<https://www.consilium.europa.eu>

JAVA EVROPIANE E SHKATHTËSIVE DHE SIGURIMI I CILËSISË NË ARSIMIN PROFESIONAL DHE TRAJNIM 2018



Java Evropiane e Shkathtësive u organizua bashkërisht nga Komisioni Evropian dhe Presidenca Austriake e Këshillit të BE-së, me 1512 ngjarje që ndodhin në Evropë me më shumë se 2.2 milion njerëz, që është 1.2 milion më shumë se vitin e kaluar. Deri në fund të dhjetorit 2018, aktivitetet dhe ngjarjet e lidhura me të do të vazhdojnë të realizohen. Me rastin e ngjarjes, Komisionari Evropian për Punësimin, Çështjet Sociale, Shkathtësitë dhe Mobilitetin e Punës, Marijana Tisen, njoftoi fituesit e Çmimit të Arsimit dhe Formimit Profesional në vitin 2018.

"Gjatë Javës Evropiane të Shkathtësive në Vjenë, përfaqësues dhe ekspertë nga shtetet anëtare të BE-së punuan intensivisht në zhvillimin e mëtejshëm të arsimit dhe aftësimin profesional në Evropë. Interesi i madh për këtë ngjarje tregon se si arsimit dhe aftësimi profesional janë të rëndësishme për plotësimin e nevojave për shkathtësi

dhe shfrytëzimin e mundësive që vijnë për ekonominë dhe shoqërinë ", tha ministri austriak për Çështjet Ekonomike dhe Dixhitale, Dr Margaret Shrambok. Kjo ngjarje organizohet me pjesëmarrjen dhe mbështetjen e dy agjencive të BE-së - Qendrës Evropiane për Zhvillimin e Arsimit Profesional (CEDEFOP) dhe Fondacionit Evropian të Trajnimit. Gjatë kësaj jave, Cedefop organizoi një konferencë mbi arsimin dhe aftësimin profesional, Aleanca Evropiane për Mësimdhënie kremtoi përvjetorin e saj të pestë dhe Komisioni organizoi një forum të OECD mbi arsimin e të rriturve. Gjatë eventit të mbylljes, në vitin 2018 u zhvillua një ceremoni shpërblymshme dhe prezantimi i Ambasadorit të Javës Evropiane në shkathtësi të fituara në arsimin dhe aftësimin profesional.

<http://europa.eu>

KANDIDATI I ZGJEDHUR I PARTISË POPULLORE EVROPIANE PËR ZGJEDHJET E EVROPIANE TË RADHËS

Partia Popullore Evropiane ka vendosur që kandidati i saj për kryetar të Komisionit Evropian të jetë Manfred Veber.

Në Kongresin e EPP që u zhvillua më 8 nëntor në Helsink, Manfred Veber i Gjermanisë ishte i preferuari dhe zgjedhja e tij pritej.

Ai do të jetë bartësi i listës së Partisë Popullore Evropiane (EPP) për zgjedhjet evropiane, të cilat do të mbahen në maj të vitit 2019.

Pas zgjedhjeve evropiane që do të mbahen nga 23 deri më 26 maj të vitit të ardhshëm, do të zgjidhen kryetari i Komisionit Evropian, Këshillit Evropian, Parlamentit Evropian dhe Bankës Qendrore Evropiane, si dhe përfaqësuesi i lartë i BE-së për politikë të jashtme.

Rezultatet zyrtare tregojnë se Veber u zgjodh me 492 vota nga 619 vota nga delegatët e EPP-së, ndërsa Finenco Aleksandar Stub fitoi 127 vota dhe dy vota të pavlefshme.

Nëse Partia Popullore Evropiane, e cila i bashkon partitë e djathta qendrore, mbeten edhe më tutje partia më e fortë në Parlamentin Evropian, pas zgjedhjeve evropiane në maj, Manfred Veber mund të pretendojë ta trashëgojë Zhan-Clod Juncker në krye të Komisionit Evropian.

Kancelarja gjermane Angela Merkel i dha mbështetje Manfred Veber për të qenë në krye të fushatës së të djathtës qendrore për zgjedhjet e Parlamentit Evropian në maj të vitit të ardhshëm.



<http://www.euractiv.rs>

PLANET I PASTËR PËR TË GJITHË - STRATEGJI E RE AFATGJATE E BE-së

Më 28 nëntor, Komisioni Evropian miratoi një vizion strategjik afatgjatë për një ekonomi të prosperuar, moderne, konkurruese dhe klimatike neutrale deri në vitin 2050 "Planet i pastër për të gjithë".

Strategjia tregon se si Evropa mund ta parashohë rrugën drejt neutralitetit të klimës duke investuar në zgjidhje teknologjike reale dhe duke harmonizuar aktivitetet në fushat kyçe si politika industriale, financimi dhe hulumtimi.

Për të arritur një ekonomi neutrale klimatike do të nevojitet një veprim i përbashkët në 7 fusha strategjike:

efikasitetin e energjisë, vendosjen e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, mobilitet i pastër, i sigurt dhe i lidhur, industri konkurruese dhe ekonomi rrethuese, infrastrukturë dhe interkoneksione, bioekonomi dhe rezervuarë natyral të karbonit për pastrimin e qymyrit si dhe magazinimin e hedhurinave nga qymyri.

përgjithshëm është 17.4%, krahasuar me rreth 17% në vitin 2016.

"Ndërsa BE në tërësi është në rrugë të mirë për të reduktuar emetimet deri në 2020 dhe rritjen e pjesëmarrjes së energjive të rinovueshme, trendet e reja në rritjen e konsumit të energjisë duhet të ndryshojnë në mënyrë që të arrihen qëllimet për vitin 2020", thuhet në Raportin e Agjencisë.

Konsumi i energjisë rritet që nga viti 2015 dhe vlerësimi paraprak i EEA-së për vitin 2017 tregon se konsumi për atë vit është më i madh se sa është parashikuar.

<https://ec.europa.eu/commission/news/banking-union-and-capital-markets-union-climate-strategy-2018>
<https://ec.europa.eu/clima>

#EU2050

Progresi në përdorimin e energjive të rinovueshme dhe efikasitetit energjetik stagon ngadalë në Bashkimin Evropian.

Sipas të dhënave të Agjencisë Evropiane të Mjedisit Jetësor (EEA), arsyeja është rritja e konsumit të energjisë, veçanërisht në fushën e transportit, sipas të dhënave paraprake të EEA-së, në vitin 2017. Sasia totale e energjisë së rinovueshme në konsumin e

SISTEMI PËR KONTROLL PËR INVESTIMET E HUAJA NË BASHKIMIN EVROPIAN



Bashkimi Evropian ka arritur një marrëveshje mbi rregullat e sistemit për kontrollin e investimeve të huaja direkte në Bashkim, kryesisht nga Kina, në mënyrë që t'i japin fund asaj që disa pjesëmarrës në negociata e kanë quajtur naivitet të Evropës.

Negociatorët nga Parlamenti Evropian dhe 28 shtete anëtare kanë rënë dakord të mbrojnë teknologjitë dhe informacionin strategjik dhe objektet e infrastrukturës vitale, siç janë portet ose rrjetet e energjisë.

Propozim-ligji i cili u përpilua pas rritjes së investimeve kineze në Evropë, parashikon që Komisioni Evropian po shqyrton investimet e huaja dhe paraqet një vlerësim.

Në radhë të parë, ky vlerësim do të merret me dilemën nëse një investim i caktuar kërcënon sigurinë e një objekti të infrastrukturës vitale dhe nëse risia pas viteve të hulumtimit mund të vijë në duart e të tjerëve.

"Të gjitha fuqitë botërore, SHBA-ja, Japonia dhe Kina kanë metoda vlerësimi, vetëm Evropa nuk i ka", theksoi negociatori i BE-së Frenk Prust në prag të një takimi në Bruksel më 20 nëntor të këtij viti.

Drafti nuk e përmend në mënyrë eksplicite Kinën, por nga vërejtjet e propozuesve që flasin për investimet në pronësi shtetërore dhe për transferin e teknologjive, ajo kryesisht lidhet me atë vend.

Komisioni Evropian propozoi në shtator të vitit 2017 të krijonte një mekanizëm për bashkëpunim në fushën e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, që do të ishte një kombinim i një baze të dhënash, shkëmbimi informacioni, në nivel të BE-së.

Qëllimi, siç shpjegoi Komisioni në atë kohë, është kufizimi i kërcënimeve financiare ndaj "infrastrukturës kritike", duke përfshirë energjinë, transportin, komunikimet, dosjet, hapësirat dhe industritë financiare dhe "teknologjitë vitale" siç janë industria e gjysmëpërçuesve, robotika dhe inteligjenca artificiale.

Dokumenti, i nisur nga Franca, Gjermania dhe qeveria e mëparshme italiane, duhet të mbështetet nga 28 shtete anëtare në takimin më 5 dhjetor, por mbështetja nuk është e garantuar për shkak të

kundërshtimit të një numri vendesh si Qiproja, Greqia, Luksemburgu, Malta dhe Portugalia.

Kundërshtarët e propozimit i përshëndesin investimet kineze, si Greqia, porti më i madh në Pirej, i cili është në pronësi të shumicës kineze.

Parlamenti i Bashkimit Evropian duhet të votojë për propozimin në mars të vitit të ardhshëm.

Drafti e ka zgjeruar listën e sektorëve vital, duke përfshirë menaxhimin me ujë, shëndetin, nanoteknologjinë, mbrojtjen, mediat, industrinë e baterive elektrike, bioteknologjinë dhe sigurinë e ushqimit.

Të gjithë anëtarët do të ishin të detyruar të dorëzojnë një raport vjetor tek Komisioni Evropian, i cili duhet të japë mendimin e tij në rast se një e treta e vendeve të BE-së shprehin shqetësime rreth disa investimeve të planifikuara të huaja.

Megjithatë, në fund të fundit, megjithatë, shtetet anëtare do të vendosin nëse do të bllokojnë investimet e huaja për arsye sigurie ose me interes publik.

<http://europa.eu>

BASHKËPUNIMI NË SFERËN E MBROJTJES - 17 PROJKETE TË REJA PESCO-s

Ministrat e jashtëm të BE-së dhe ministrat e mbrojtjes kanë dakord mbi 17 projekte të reja në sferën e ushtrisë dhe industrisë ushtarake në suaza të marrëveshjes bashkëpunim strukturor të përhershëm (PESCO), duke përfshirë zhvillimin e sistemeve të reja për armë dhe krijimin e një shkolle trajnimit.

Projektet ushtarake nën kujdesin e marrëveshjes PESCO, integrimet filluar në dhjetor të vitit 2017, duke përfshirë forcat e armatosura të 25 vendeve anëtare të BE-së, kanë të bëjnë me trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteteve, gatishmërinë operative për tokën, detin dhe ajrin dhe mbrojtjen kibernetike.

Selia e shkollës së përbashkët të zbulimit, për të cilën 25 ministra arritën një marrëveshje më 19 nëntor në Bruksel, do të jetë në Qipro dhe qëllimi i shkollës do të jetë trajnimi i personelit të zbulimit nga e gjithë BE-ja në bashkëpunim me agjencitë nacionale të zbulimit dhe NATO-n.

Sipas listës së projekteve të reja, Gjermania do të angazhohet në zhvillimin e një brezi të ri të avionëve pa pilot për mbikëqyrjen e tokës dhe detit, dhe së bashku me Francën dhe Spanjën do të punojnë për të përmirësuar karakteristikat e helikopterit evropian të sulmeve Tigër mk 3.

Në projektet tjera janë edhe automjeti i blinduar evropian për luftim, ekipet e mbrojtjes sajber dhe avionë shumë-atmosferikë që do të përdoren për të mbledhur informacione dhe zbulime.

Vendet anëtare të BE-së miratuan gjithashtu konkluzione mbi përf forcimin e komponentit civil të sigurisë së përbashkët Evropiane dhe

Politikës së Mbrojtjes (CSDP), e cila duhet të forcojë aftësinë e BE-së për të vendosur misionet civile të menaxhimit me krizat. Qëllimi i këtyre misionëve do të jetë mbështetja e policisë, sundimi i së drejtës dhe administrata civile në situata të rrezikshme dhe luftarake.

PESCO u fillua në vitin 2017 për të sjellë BE më afër bashkimit të përbashkët të mbrojtjes të planifikuar dhe për ta bërë bashkimin më fleksibil në kuptimin mbrojtës, por më pak të varur nga SHBA-ja.

Danimarka, Malta dhe Britania e Madhe nuk janë kyçur në projektet e PESCO-s. Takimi i parë i ministrave në formatin PESCO u mbajt më 6 mars të vitit 2018, kur u miratuan 17 projektet e para, nga gjithsej 34, ku anëtarët e BE-së do të bashkëpunojnë sipas dëshirës.

<https://www.consilium.europa.eu>



KALENDARI I BE-së / dhjetor 2018

1. Dita evropiane e personave me aftësi të kufizuara 2018, 03-04/12/2018, Bruksel, Belgjikë;
2. Konferenca TKI 2018: Mendoni në mënyrë digjitale - lidheni Evropën, 04-06/12/2018, Vjenë, Austri;
3. Sesion plenar i Parlamentit Evropian, 10-13/12/2018, Strasburg;
4. Takim i këshillit për punë të përgjithshme, 11/12/2018, Bruksel, Belgjikë;
5. Dita evropiane e energjisë 2018, 11/12/2018, Katovicë, Poloni.

European Union
 Newsroom
europa.eu

[EUROPA](#) > [Newsroom](#) > [Calendar](#)

[Home](#) | [Highlights](#) | [Press releases](#) | **[Calendar](#)** | [Audiovisual](#) | [Press contacts](#) | [Press facilities](#) | [About the EU](#) | [Subscription services](#)

CALENDAR

BROWSE FORTHCOMING EVENTS

By topic

By organiser

By type

BY MONTH

December

Sun	Mon	Tue	Wed	Thu	Fri	Sat
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					



KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

BE QENDRA E KUVENDIT

Adresa: 11 Tetori nr. 10, shkup, 1000

Telefon: +389 2 3 11 22 55 lokal 414 dhe 289

Faks: +389 2 3 182 277

E-mail: nsei@sobranie.mk

Zyra 019

www.sobranie.mk

Në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë u zbatua Projekti IPA "Ndihmë Teknike për Parlamentin" në periudhën janar 2011- qershor 2012, qëllimi i të cilit ishte përforcimi i kapacitetit institucionale të Kuvendit dhe me këtë përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësië ndaj qytetarëve.

Në kuadër të projektit IPA, u siguroa ndihma financiare dhe eksperte për krijimin e një qendre të BE-së në Parlament.

Qëllimi i formimit të Qendrës së BE-së është t'i sigurojë deputetëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe shërbimit të Kuvendit qasje më të mirë në informata lidhur me çështjet e BE-së.

Qendra e BE-së është e organizuar në kuadër të Sektorit për Mbështetjen e Këshillit Nacional për Eurointegritim.

Qendra e BE-së disponon me bibliotekë librash dhe botimesh nga fusha të ndryshme të politikave evropiane.

